Secila nga këto objektiva strategjike është zbërthyer më tej në rezultatet e pritshme, objektivat specifike, treguesit e matjes së tyre, si dhe në masa e veprime konkrete, të cilat detajohen në matricën e planit të veprimit, ku jepet një informacion më i plotë për zbatimin dhe vlerësimin e rezultateve.

Përparimi dhe efektiviteti në zbatimin e PLVBGJ kërkon domosdoshmërisht vënien në dispozicion të burimeve të nevojshme dhe të mjaftueshme njerëzore, financiare e infrastrukturore, si dhe koordinimin e veprimeve dhe bashkëpunimin ndërinstitucional me institucionet e tjera lokale, organizatat e shoqërisë civile, institucionet private, si dhe organizatat ndërkombëtare të cilat punojnë për fuqizimin e grave dhe arritjen e barazisë gjinore. Mbledhja dhe përditësimi rregullisht i të dhënave të ndara jo vetëm sipas seksit, por edhe sipas një tërësie karakteristikash të tjera individuale, monitorimi i vazhdueshëm mbi ecurinë e zbatimit të veprimeve të parashikuara, si dhe transparenca e llogaridhënja për rezultatet e arritura, janë gjithashtu domosdoshmëri për të përparuar drejt vizionit që udhëheq këtë PLVBGJ.

Rezultatet e pritshme, objektivat specifike dhe treguesit

Objektivi strategjik:
1. Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre.
Rezultatet e pritshme:
1.a. Pjesëmarrja e të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike e publike, e përmirësuar.
1.b. Planet e zhvillimit dhe ndërhyrjes në të gjitha fushat, si dhe programet buxhetore të Komunës, me perspektivën gjinore të integruar.
Objektivat specifike:
1.1. Rritja e pjesëmarrjes dhe krijimi i mundësive të barabarta për leadership në vendimmarrjen politike e publike, për gratë, të rejtat dhe vajzat, në të gjithë diversitetin e tyre, duke sfiduar

normat shoqërore diskriminuese dhe stereotipet gjinore, që nxitin pabarazitë dhe diskriminimin e shumëfishtë e të ndërthurur. 1.2. Rritja e masave dhe veprimeve të Komunës që marrin parasysh e zbatojnë integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.
Treguesit në nivel objektiv: 1.1.a. Numri i grave, të rejave e vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, të informuara mbi të drejtat dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë në vendimmarrjen politike e publike. 1.2.a. Përqindja e buxhetit komunal dedikuar veprimeve për fuqizimin e grave dhe përparimin drejt barazisë gjinore.
Objektivi strategjik: 2. Promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese.
Rezultatet e pritshme: 2.a. Edukimi mbi shëndetin seksual e riprodhues mes profesionisteve/profesionistëve dhe në komunitet, merr rëndësi të veçantë. 2.b. Vendimmarrja tek vajzat, djemtë, të rejtat, të rinjtë, gratë dhe burrat për shëndetin seksual e riprodhues, e përmirësuar ndjeshëm.
Objektivi specifik: 2.1. Rritja e qasjes së grave, të rejave, e vajzave si dhe burrave, të rinjve e djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, në shërbime cilësore shëndetësore dhe të shëndetit seksual e riprodhues.
Treguesi në nivel objektiv: 2.1.a. Numri i grave, të rejave, vajzave, si dhe burrave, të rinjve e djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, me akses të shtuar në kujdesin dhe shërbimet shëndetësore seksuale dhe riprodhuese.
Objektivi strategjik: 3. Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave.
Rezultatet e pritshme: 3.a. Pjesëmarrja e grave dhe të rejave në aplikimin dhe përfitimin e subvencioneve të komunës në lidhje me bujqësinë dhe zhvillimin ekonomik, e përmirësuar ndjeshëm. 3.b. Mbështetja e komunës me shërbime sociale cilësore e të ndjeshme gjinore, e rritur.
Objektivat specifike: 3.1. Rritja e qasjes së grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, ndaj shërbimeve, produkteve dhe burimeve financiare që ndikojnë në fuqizimin ekonomik të tyre. 3.2. Rritja e qasjes së grave, burrave, të rejave, të rinjve, vajzave e djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, në shërbime sociale cilësore, gjithëpërfshirëse e të përgjegjshme gjinore.
Treguesit në nivel objektiv: 3.1.a. Numri i grave / të rejave fermere e në ndërmarrësi, përfituese të granteve dhe subvencioneve të Komunës. 3.2.a Numri i banoreve/banorëve të komunës që përfitojnë nga shërbimet sociale cilësore, gjithëpërfshirëse e të përgjegjshme gjinore.
Objektivi strategjik: 4. Zvogëlimi i pabarazive gjinore në arsim cilësor, kulturë e sport, për gratë, burrat, të rejtat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre.
Rezultatet e pritshme: 4.a. Numri i grave, të rejave e vajzave në të gjithë diversitetin e tyre, të përfshira në arsim cilësor e në procesin e të mësuarit gjatë gjithë jetës, rritur ndjeshëm. 4.b. Mundësitë e barabarta për angazhim dhe vlerësim të figurave të artit, kulturës e sportit, për gratë, burrat, të rejtat, të rinjtë, vajzat e djemtë, të përmirësuar.
Objektivat specifike: 4.1. Ofrimi i mundësive të barabarta për arsim cilësor e të mësuarit gjatë gjithë jetës, për vajzat, të rejtat dhe gratë, si dhe djemtë, të rinjtë e burrat e Komunës, në të gjithë diversitetin e tyre. 4.2. Promovimi i modeleve të suksesshme të grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, që investojnë dhe marrin pjesë aktivisht në art, kulturë dhe sport.

Treguesit në nivel objektiv:

4.1.a. Numri i vajzave, të rejave dhe grave nga të gjitha grupet, të përfshira në shërbime cilësore të arsimit dhe formimit profesional.

4.2.a. Numri i grave të rejave dhe vajzave që promovohen si modele të suksesshme në art, kulturë dhe sport.

Objektivi strategjik:

5. Liri nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore.

Rezultatet e pritshme:

5.a. Gratë, burrat, të rejtat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre, janë agjentë të ndryshimit për një shoqëri të mundësive të barabarta e pa dhunë.

Objektivi specifik:

5.1. Fuqizimi i Mekanizmit Koordinues në mbrojtje të viktimave/të mbijetuarave / mbijetuarve të dhunës në familje e dhunës me bazë gjinore.

Tregues në nivel objektiv:

5.1.a. Numri i rasteve të menaxhuara me efektivitet e në mënyrë shumë-sektoriale të koordinuar, nga anëtarët e Mekanizmit Koordinues në Prizren.

V. KOSTO PËR ZBATIMIN E PLVBGJ MAJ 2024 - 2026

Të gjitha aktivitetet e parashikuara në matricën e PLVBGJ 2024 - 2026 shoqërohen edhe me një kosto financiare të domosdoshme për zbatimin e tyre, e cila zbërthehet më tej në kosto që mbulohet nga vetë Komuna (si me burimet ekzistuese njerëzore, financiare e infrastrukturore, ashtu edhe me burime që duhet të shtojë), kosto që mbulohet nga donatorët dhe palët e treta, si dhe kosto që ka nevojë për t'u siguruar (apo hendeku financiar).

Është e rëndësishme të theksohet se ndonëse një pjesë të mirë të aktiviteteve Komuna e mbulon përmes angazhimit të burimeve ekzistuese njerëzore e financiare (pra zyrtareve / zyrtarëve, të cilat/cilët aktualisht marrin një pagë fikse, sallave/ambienteve që ka në pronësi për të zhvilluar aktivitete të ndryshme, apo vënien në dispozicion të makinës dhe materialeve kancelarike të cilat blihen në total për të gjithë institucionin, etj.), në këtë Plan Lokal Veprimi për Barazinë Gjinore 2024 - 2026 evidentohet edhe vlera përkatëse e këtij kontributi, me qëllim që gjatë monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të tij, të mundësohet vlerësimi edhe përmes kosto-eficencës. Është e rëndësishme të mbahet në konsideratë fakti që këto përllogaritje janë bërë për minimumin e vlerave që do të kërkonte organizimi i aktiviteteve të propozuara.

Kostot e paraqitura janë orientuese dhe miratimi i këtij Planit Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2024 - 2026, të kostuar, nuk nënkupton automatikisht edhe buxhetimin e tij. Për të buxhetuar dhe alokuar fondet përkatëse të përvitshme, pa të cilat zbatimi i këtij PLVBGJ nuk merr jetë, Komuna duhet të përfshijë në kornizën e parashikimeve buxhetore vjetore dhe afatmesme edhe masat e parashikuara në këtë PLVBGJ. Në këtë kuadër edhe mbështetja dhe lobimi nga vetë Grupi Jo-Formal i Grave për sigurimin e burimeve financiare për realizimin e aktiviteteve/masave, përmes përfshirjes së tyre në buxhete vjetore apo afatmesme të Komunës, është domosdoshmëri.

Me rishikimin e përvitshëm të Planit Lokal të Veprimit, ***duhet bërë patjetër edhe rishikimi i kostove të propozuara***, bazuar edhe në mënyrën e përfshirjes së tyre në buxhetet vjetore apo KAB-et e Komunës, si dhe në marrëveshjet me donatorët apo partnerët e mundshëm. Kjo kërkon një vëmendje të shtuar sidomos në periudhën e përgatitjes së KAB-eve dhe buxheteve vjetore, për të përfshirë në to masat dhe veprimet e parashikuara në matricën e PLVBGJ, sipas ndarjeve në vite.

Nga përllogaritjet e bëra rezulton se kostot në tërësi për zbatimin e PLVBGJ 2024 - 2026 janë në vlerën **3,263,065 EUR**. Nga këto:

- **243,765 EUR** janë kosto për zbatimin e objektivit strategjik 1. Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre.

- **136,315 EUR** janë kosto për zbatimin e objektivit strategjik 2. Promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese.
- **2,203,300 EUR (ku përfshihen grante dhe subvencione në total të parashikuara nga komuna)** janë kosto për zbatimin e objektivit strategjik 3. Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave.
- **616,740 EUR** janë kosto për zbatimin e objektivit strategjik 4. Zvogëlimi i pabarazive gjinore në arsim cilësor, kulturë e sport, për gratë, burrat, të rejat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre.
- **62,945 EUR** janë kosto për zbatimin e objektivit strategjik 5. Liri nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore.

Në totalin e koston **3,263,065 EUR** të nevojshme për zbatimin në tërësi të PLVBGJ 2024 - 2026 për të gjithë kohëzgjatjen e tij (tre vite):

- **3,105,428 EUR janë kosto që do të mbulohen nga Komuna** (me stafin ekzistues dhe me kontribut në natyrë – salla, mjete, etj.), pra **të cilat nuk kanë nevojë të përlllogariten si shtesë në buxhet, sepse edhe burimet njerëzore edhe infrastrukture ekzistojnë. Këtu përfshihen edhe grante apo subvencionime të planifikuara për fusha të caktuara dhe për banoret dhe banorët në të gjithë diversitetin e tyre dhe vit pas viti do maten se sa kanë përfituar gratë, të rejat dhe vajzat në veçanti.**
- **28,353 EUR janë kosto që mbulohen nga donatorë** të ndryshëm (të cilët kanë dakordësuar paraprakisht gjatë përgatitjes së draft PLVBGJ-së).
- **129,285 EUR (ose 4% e totalit të buxhetit të tre viteve) janë hendek financiar**, për të cilat komuna do të llojë për gjetjen e burimeve financuese, ose do të bëjë planifikimet e saj shtesë në KAB-et e ardhshme, duke filluar nga KAB 2025 - 2027.

Objektivat strategjikë	Objektivat specifike	Gjithsej kosto për tre vjet	Komuna	Donatorë të konfirmuar	Hendek financiar
1. Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre.	1.1. Rritja e pjesëmarrjes dhe krijimi i mundësive të barabarta për lidërsip në vendimmarrjen politike e publike, për gratë, të rejat dhe vajzat, në të gjithë diversitetin e tyre, duke sfiduar normat shoqërore diskriminuese dhe stereotipet gjinore, që nxitin pabarazitë dhe diskriminimin e shumëfishtë e të ndërthurur.	117,700 EUR	37,973 EUR	15,618 EUR	64,110 EUR
	1.2. Rritja e masave dhe veprimeve të Komunës që marrin parasysh e zbatojnë integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.	126,065 EUR	71,890 EUR	11,235 EUR	42,940 EUR
	Gjithsej Objektivi strategjik 1:	243,765 EUR	109,863 EUR	26,853 EUR	107,050 EUR

2. Promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese.	2.1. Rritja e qasjes së grave, të rejave, e vajzave si dhe burrave, të rinjve e djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, në shërbime cilësore shëndetësore dhe të shëndetit seksual e riprodhues.	136,315 EUR	133,315 EUR	1,500 EUR	1,500 EUR
Gjithsej Objektivi strategjik 2:		136,315 EUR	133,315 EUR	1,500 EUR	1,500 EUR
3. Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave.	3.1. Rritja e qasjes së grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, ndaj shërbimeve, produkteve dhe burimeve financiare që ndikojnë në fuqizimin ekonomik të tyre.	6,300 EUR	6,300 EUR	0 EUR	0 EUR
	3.2. Rritja e qasjes së grave, burrave, të rejave, të rinjve, vajzave e djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, në shërbime sociale cilësore, gjithëpërfshirëse e të përgjegjshme gjinore.	2,197,000 EUR	2,191,000 ¹² EUR	0 EUR	6,000 EUR
Gjithsej Objektivi strategjik 3:		2,203,300 EUR	2,197,300 EUR	0 EUR	6,000 EUR
4. Zvogëlimi i pabarazive gjinore në arsim cilësor, kulturë e sport, për gratë, burrat, të rejtat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre.	4.1. Ofrimi i mundësive të barabarta për arsim cilësor e të mësuarit gjatë gjithë jetës, për vajzat, të rejtat dhe gratë, si dhe djemtë, të rinjtë e burrat e Komunës, në të gjithë diversitetin e tyre.	613,800 EUR	613,800 ¹³ EUR	0 EUR	0 EUR
	4.2. Promovimi i modeleve të suksesshme të grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, që investojnë dhe marrin pjesë	2,940 EUR	1,380 EUR	0 EUR	1,560 EUR

¹² Këtu futen edhe subvencionet në total për të gjitha familjet skamnore. Ndarja sipas kryefamiljareve gra, do të bëhet në raportimet e përvitshme

¹³ Këtu përfshihen edhe bursat dhe investimet në total. Komuna do raportojë në mënyrë të përvitshme sa % e këtij buxheti shkon për gratë, të rejtat dhe vajzat.

	aktivisht në art, kulturë dhe sport.				
Gjithsej Objektivi strategjik 4:		616,740 EUR	615,180 EUR	0 EUR	1,560 EUR
5. Liri nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore.	5.1. Fuqizimi i Mekanizmit Koordinues në mbrojtje të viktimave/të mbijetuarave / mbijetuarve të dhunës në familje e dhunës me bazë gjinore.	62,945 EUR	49,770 EUR	0 EUR	13,175 EUR
Gjithsej Objektivi strategjik 5:		62,945 EUR	49,770 EUR	0 EUR	13,175 EUR

Për më shumë detaje, lutemi referohuni tek Matrica e Planit Lokal të Veprimit në vijim.

VI. RAPORTIMI DHE MONITORIMI

Procesi i raportimit për aktivitetet e zbatuara do të kryhet nga Drejtoria përgjegjëse për zbatimin e aktivitetit tek *Zyra e Kryetarit*.

Menjëherë pas miratimit të Planit Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2024 - 2026, si hap i parë i zbatimit të tij, do të mbledhen të dhënat për vlerën bazë të treguesve në nivel të objektivave specifike. Po kështu do të hartohen edhe fletët e treguesve me informacionin që duhet të mbledhet dhe raportohet në bazë aktiviteti, por edhe në bazë të objektivave specifike. **Raportimet në bazë të objektivave specifike** do të përgatiten **dy herë në vit (çdo 6 muaj)** ose në bazë të kërkesës së Zyrës së Kryetarit.

Monitorimi i zbatimit të Planit Vendor të Veprimit **në nivel të objektivave** do të kryhet nga **Komiteti për Barazi Gjinore (KBGJ)** dhe **Grupi Jo Formal i Grave (GG)** në nivel të **Kuvendit Komunal**. Raportet e përgatitura do të përcillen sipas nevojës/kërkesës edhe në Agjencinë për Barazi Gjinore apo në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Bazuar në monitorimin e kryer, PLVBGJ **duhet të rishikohet dhe përmirësohet** në mënyrë periodike dhe të paktën çdo një vit nga data e fillimit të zbatimit të tij.

VII. MATRICA E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2024 - 2026

OBJEKTIVI STRATEGJIK:	1. PROMOVIMI I BARAZISË GJINORE DHE FUQIZIMI I GRAVE, TË REJAVE DHE VAJZAVE NË TË GJITHË DIVERSITETIN E TYRE.								
Rezultatet e pritshme:	1.a. Pjesëmarrja e të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike e publike, e përmirësuar. 1.b. Planet e zhvillimit dhe ndërhyrjes në të gjitha fushat, si dhe programet buxhetore të Komunës, me perspektivën gjinore të integruar.								
Referenca në dokumentet kryesore:	- Ligji Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore, nenet 1, 2, 4, 5, 6, 12. - Programi i Kosovës për Barazinë Gjinore 2020 – 2024, objektivi strategjik 1, objektivi specifik 1.2, objektivi strategjik 3, objektivat specifike 3.1 dhe 3.2. - Plani i Zbatimit në Nivel Vendi për Kosovën i Planit të Veprimit të BE-së për Barazinë Gjinore III (EU GAP III) 2021-2025, fusha tematike 1, objektivat specifike 3.2 dhe 3.7, fusha tematike 4, objektivat specifike 4.1, 4.2 dhe 4.4. - Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) – nenet 2, 3, 4, 5 dhe 7. - Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) – nenet 4 dhe 6. - Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA), fushat kritike 7, 8 dhe 9. - Agjenda 2030, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) 2030, SDG 5, target 5.1, 5.2, 5.3, 5.4, 5.a dhe 5.c, treguesit 5.1.1, 5.2.1, 5.2.2, 5.3.1, 5.4.1, 5.5.1, 5.5.2, 5.a.1, 5.a.2 dhe 5.c.1; SDG 16, target 16.7 dhe 16.b, treguesit 16.7.1, 16.7.2 dhe 16.b.1 - Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i BE-së 2021 – 2025 (EU GAP III), fusha tematike 4. - Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, nenet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10.								
Objektivi specifik:	1.1. Rritja e pjesëmarrjes dhe krijimi i mundësive të barabarta për leadership në vendimmarrjen politike e publike, për gratë, të rejat dhe vajzat, në të gjithë diversitetin e tyre, duke sfiduar normat shoqërore diskriminuese dhe stereotipet gjinore, që nxitin pabarazitë dhe diskriminimin e shumëfishtë e të ndërthurur.								
Treguesi			Vlera bazë (2024)	Synimi i vitit të fundit (2026)	Rezultati				
1.1.a. Numri i grave, të rejave e vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, të informuara mbi të drejtat dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë në vendimmarrjen politike e publike.			Do përcaktohet	Rritur me 10%	Më shumë vajza, të reja e gra, në të gjithë diversitetin e tyre, informohen e vetëdijesohen për të drejtat dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë në vendimmarrjen politike e publike.				
AKTIVITETET	ZBATIMI		AFATI KOHOR	KOSTO (€)			BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESIT	MONITORIMI
	Drejtoria / zyra përgjegjëse	Drejtoritë/ zyrat mbështetëse		2024	2025	2026			
1.1.1. Takime informuese me gratë dhe të rejat, në të gjithë diversitetin	Grupi Jo-Formal i Grave (GG)	Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe	2024 - 2026	1,220 € (komuna)	1,220 € (komuna)	1,220 € (komuna)	Zyra e Kryetarit (ZK)	- 6 takime të zhvilluara (2 në vit)	Komiteti për Barazi Gjinore (KBGJ)

e tyre, mbi rëndësinë e pjesëmarrjes në Këshillat Lokale.		Barazinë Gjinore (NJDNJBGJ) Organizatat jo Qeveritare (OJQ) Organizatat Ndërkombëtare (ON)						- 240 gra të informuara (80 në vit), ndarë sipas moshës, etnisë, vendbanimit, etj.	Grupi Jo Formal i Grave (GG)
1.1.2. Identifikimi i nevojave dhe organizimi i një trajnimi/ apo aktiviteteve për fuqizimin e kapaciteteve për gratë dhe burrat e zgjedhur si kryetare/kryetarë të fshatrave dhe Këshillave Lokale	NJDNJBGJ	GG OJQ ON	2025 - 2026	/	Do përlogarit në bazë të vlerësimit të nevojave dhe kërkesave të tyre	Do përlogarit në bazë të vlerësimit të nevojave dhe kërkesave të tyre	NJDNJBGJ Donatorët	- Numri i aktiviteteve për fuqizimin e kapaciteteve të zhvilluara dhe numri i personave të përfshirë, ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, pozicionit, etj.	KBGJ GG
1.1.3. Sesione informuese me nxënëset / nxënësit dhe studentet/studentët mbi pjesëmarrjen dhe lidhshpimin e barabartë gjinor, si dhe për çështje të tjera të fuqizimit të gruas e barazisë gjinore, në shkollat e komunës.	Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA)	NJDNJBGJ Shkollat OJQ ON	2024 - 2026	3,715 € (nga të cilat 2,423 € komuna dhe 1,293 € donatori)	3,715 € (nga të cilat 2,423 € komuna dhe 1,293 € donatori)	3,715 € (nga të cilat 2,423 € komuna dhe 1,293 € donatori)	DKA Donatorët ¹⁴	33 sesione të zhvilluara (9 sesione në shkollat dhe 2 sesione në universitet, në vit) - 825 persona të informuar (275 në vit),	KBGJ GG

¹⁴ Për këtë aktivitet do të kontribuojë edhe Qendra për Barazi dhe Drejtësi, Prizren

								ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, vendbanimit, etj.	
1.1.4. Sesione informuese /trajnuese mbi barazinë gjinore dhe rëndësinë e integritetit gjinor në politikat lokale, për Grupin Jo Formal të Grave.	Kuvendi Komunal	NJDNJBGJ OJQ ON	2024 - 2026	520 € (nga të cilat 300 € komuna dhe 220 € donatori)	520 € (nga të cilat 300 € komuna dhe 220 € donatori)	520 € (nga të cilat 300 € komuna dhe 220 € donatori)	ZK Donatorët ¹⁵	- 6 sesione të zhvilluara (2 në vit) - 10 asambleiste të informuara, ndarë sipas moshës, pozitës, partisë politike, etj.	KBGJ GG
1.1.5. Aktivitete sensibilizuese në kuadër të “Javës së Gruas” (8 Mars).	NJDNJBGJ	GG OJQ ON	2024 - 2026	2,430 € (nga të cilat 1,080 € komuna dhe 1,350€ donatori)	2,430 € (nga të cilat 1,080 € komuna dhe 1,350€ donatori)	2,430 € (nga të cilat 1,080 € komuna dhe 1,350€ donatori)	ZK Donatorët ¹⁶	- 15 aktivitete të zhvilluara (5 në vit) - 300 persona të informuar (100 në vit), ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, etj.	KBGJ GG
1.1.6. Aktivitete vetëdijesuese për shënimin e ditës (ditëve) ndërkombëtare të vajzave ¹⁷ .	NJDNJBGJ	DKA GG	2024 - 2026	2,060 €	2,060 €	2,060 €	ZK	- 6 aktivitete të zhvilluara (2 në vit)	KBGJ GG

¹⁵ Për këtë aktivitet do të kontribuojë edhe DEMOS

¹⁶ Për këtë aktivitet do të kontribuojë edhe Qendra për Barazi dhe Drejtësi, Prizren

¹⁷ Data **11 tetor** është shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara si Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve Vajza, për të njohur të drejtat e vajzave dhe sfidat unike me të cilat përballen vajzat në mbarë botën (miratuar me Rezolutën 66/170, datë 19 dhjetor 2011). Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve Vajza fokuson vëmendjen në nevojën për të adresuar sfidat me të cilat përballen vajzat dhe për të promovuar fuqizimin e vajzave dhe përmbushjen e të drejtave të tyre njerëzore. Për më shumë shih: <https://www.un.org/en/observances/girl-child-day> Ditë të tjera ndërkombëtare të lidhura me fëmijët (pra vajza dhe djem), si dhe me të rejtat e të rinjtë, janë: 12 qershori – Dita botërore kundër punës së fëmijëve, 12 gushti – Dita ndërkombëtare e rinisë, 20

		OJQ ON		(nga të cilat 1,330€ komuna dhe 730 € donatori)	(nga të cilat 1,330€ komuna dhe 730 € donatori)	(nga të cilat 1,330€ komuna dhe 730 € donatori)	Donatorët ¹⁸	- 300 persona të informuar (100 në vit), ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, etj.	
1.1.7. Takime vetëdijesuese për ndërgjegjësimin e prindërve (nëna dhe baballarë), si dhe të vajzave e djemve, për parandalimin e martesave të hershme.	Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (DPMS)	NJDNJBGJ DKA OJQ ON	2024 - 2026	1,140 € (nga të cilat 770 € komuna dhe 370 € hendet financiar)	1,140 € (nga të cilat 770 € komuna dhe 370 € hendet financiar)	1,140 € (nga të cilat 770 € komuna dhe 370 € hendet financiar)	ZK Donatorët	- 6 takime të zhvilluara (3 në vit) - 135 persona të informuar (45 në vit), ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, etj.	KBGJ GG
1.1.8. Promovimi i rolit të rëndësishëm të grave në proceset zhvillimore të shoqërisë duke evidentuar modelet pozitive të grave në vendimmarrjen politike e publike.	GG	NJDNJBGJ DKA Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik (DTZHE) OJQ ON	2024 - 2026	830 € (komuna)	830 € (komuna)	830 € (komuna)	ZK Donatorët	- 6 takime promovuese të zhvilluara (2 në vit). -180 persona të informuar (60 në vit), ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, aftësive, etj. - Numri i modeleve të grave në	KBGJ GG

nëntori – Dita botërore e fëmijëve; në prill (data ndryshon çdo vit, nga 22-28 prill) – dita ndërkombëtare e vajzave në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, etj. Për më shumë shih kalendarin e ditëve ndërkombëtare në: <https://www.un.org/en/observances/list-days-weeks>

¹⁸ Për këtë aktivitet do të kontribuojë edhe Qendra për Barazi dhe Drejtësi, Prizren

								vendimmarrje të promovuara çdo vit	
1.1.9. Publikimi i revistës “Barazia Gjinore në Fokus”.	Drejtoria e Administratës (DA)	NJDNJBGJ Të gjitha drejtoritë komunale GG OJQ ON	2025 - 2026	/	31,650 € (nga të cilat 450 € komuna dhe 31,200 € hendek financiar ¹⁹)	31,650 € (nga të cilat 450 € komuna dhe 31,200 € hendek financiar ²⁰)	ZK Donatorët	- Revista “Barazia Gjinore në Fokus” e publikuar dhe shpërndarë çdo 2 muaj (nga 500 copë për çdo botim)	KBGJ GG
1.1.10. Takime me të punësuarat/punësuarit në institucione lokale dhe diskutimi mbi rëndësinë e njohjes dhe raportimit të ngacmimeve seksuale në vendin e punës.	NJDNJBGJ	OJQ ON	2024 - 2026	3,740 € (nga të cilat 2,620 € komuna dhe 1,120 € donatori)	3,740 € (nga të cilat 2,620 € komuna dhe 1,120 € donatori)	3,740 € (nga të cilat 2,620 € komuna dhe 1,120 € donatori)	ZK Donatorët ²¹	- 42 takime të zhvilluara (14 në vit) - 420 persona të informuar (140 në vit), ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, etj.	KBGJ GG
1.1.11. Hartimi dhe miratimi i një politike komunale kundër ngacmimit seksual në vendin e punës.	DA	Zyra Ligjore (ZL) NJDNJBGJ GG	2024	7,875 € (nga të cilat 5,300 € komuna dhe 2,575 € donatori)	/	/	DA Donatorët ²²	- Politika e hartuar dhe miratuar	KBGJ GG

¹⁹ Organizatat Jo Qeveritare janë angazhuar se do të mbështetin komunën për të mbuluar këtë hendek financiar

²⁰ Njëlloj si më sipër

²¹ Për këtë aktivitet do të kontribuojë edhe Qendra për Barazi dhe Drejtësi, Prizren

²² Për këtë aktivitet do të kontribuojë Qendra për Barazi dhe Drejtësi, Prizren si dhe UN Women

		OIQ ON							
1.1.12. Fillimi i punës për ngritjen e Muzeut të Nënë Terezës.	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (DKRS)	DTZHE DA ON	2025 - 2026	/	Do përlogaritët varësisht hapave që do hidhen gjatë vitit	Do përlogaritët varësisht hapave që do hidhen gjatë vitit	DKRS Donatorët	- Procedurat për ngritjen e Muzeut të përfunduara së bashku me studimin e fizibilitetit; - Puna për ngritjen e muzeut e filluar	KBGJ GG
1.1.13. Miratimi i masave të veçanta ²³ që sigurojnë barazi gjinore në praktikë, në pozitat vendimmarrëse të ekzekutivit komunal, për shtimin e zyrtareve gra / të reja në të gjitha drejtoritë komunale sipas nevojës.	DA	ZL NJDNJBGJ GG OIQ ON	2024	2,650 € (nga të cilat 2,050 € komuna dhe 600 € hendek financiar)	/	/	DA	- Masat e hartuara dhe miratuara	KBGJ GG
Objektivi specifik:	1.2. Rritja e masave dhe veprimeve të Komunës që marrin parasysh e zbatojnë integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.								
Treguesi			Vlera bazë (2024)		Synimi i vitit të fundit (2026)		Rezultati		

²³ Vendosja e poenteve, sistemit të kuotave apo zbatimi i masave të tjera të përcaktuara në Ligjin 05/L -020 “Për Barazi Gjinore”, që mundësojnë pjesëmarrjen e barabartë gjinore në Këshillat Lokalë, në përzgjedhjen dhe punësimin e zyrtareve/zyrtarëve në pozitat vendimmarrëse në komunë, institucionet lokale publike (shkolla, shëndetësi, etj.), si dhe gjatë plotësimit të vendeve në drejtoritë përkatëse komunale me zyrtare gra / të reja.

1.2.a. Përqindja e buxhetit komunal dedikuar veprimeve për fuqizimin e grave dhe përparimin drejt barazisë gjinore.			Do përcaktohet	Rritur me 6%		Komuna do të hedhë hapa konkretë për integrimin gjinor në të gjithë fushat e veprimtarisë së saj, që do të realizohen duke përdorur si mjet kryesor buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.			
AKTIVITETET	ZBATIMI		AFATI KOHOR	KOSTO (€)			BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESIT	MONITORIMI
	Drejtoria / zyra përgjegjëse	Drejtoritë/ zyrat mbështetëse		2024	2025	2026			
1.2.1. Takime koordinuese me institucionet lokale, OJQ dhe ON për zbatimin e PLVBGJ.	NJDNJBGJ	Drejtoritë komunale përgjegjëse për zbatimin e PLVBGJ	2024 - 2026	365 € (komuna)	365 € (komuna)	365 € (komuna)	ZK Donatorët	- 3 takime të zhvilluara (1 në vit) - 60 persona të përfshirë (20 në vit), ndarë sipas seksit, institucionit, etj - Plani i punës i koordinuar për zbatimin e PLVBGJ i përgatitur çdo vit	KBGJ GG
1.2.2. Ngritja e kapaciteteve të zyrtareve / zyrtarëve të komunës, për integrimin gjinor, vlerësimin e ndikimit gjinor në politika publike në nivel lokal.	NJDNJBGJ	OJQ ON	2024 - 2026	2,360 € (nga të cilat 300 € komuna, 1,030 € donatori dhe 1,030 € hendek financiar)	2,360 € (nga të cilat 300 € komuna dhe 2,060 € hendek financiar)	2,360 € (nga të cilat 300 € komuna dhe 2,060 € hendek financiar)	ZK Donatorët ²⁴	- 6 trajnime të zhvilluara (2 në vit). - 90 persona të trajnuar (30 në vit) ndarë sipas seksit, moshës, profesionit, etj.	KBGJ GG

²⁴ Për të realizuar këto trajnime do ofrojë mbështetje edhe UN Women.

1.2.3. Ngritja e kapaciteteve të zyrtareve / zyrtarëve të komunës, për aplikimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor.	NJDNJBGJ	OJQ ON	2024 - 2026	2,360 € (nga të cilat 300 € komuna, 1,030 € donatori dhe 1,030 € hendek financiar)	2,360 € (nga të cilat 300 € komuna dhe 2,060 € hendek financiar)	2,360 € (nga të cilat 300 € komuna dhe 2,060 € hendek financiar)	ZK Donatorët ²⁵	- 6 trajnime të zhvilluara (2 në vit). - 90 persona të trajnuar (30 në vit) ndarë sipas seksit, moshës, profesionit, etj.	KBGJ GG
1.2.4. Aplikimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor (BPGJ) nga drejtoritë e komunës.	Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave (DEF)	Drejtoritë komunale OJQ ON	2024 - 2026	1,375 € (nga të cilat 375 € komuna dhe 1,000 € donatori)	1,375 € (nga të cilat 375 € komuna dhe 1,000 € donatori)	1,375 € (nga të cilat 375 € komuna dhe 1,000 € donatori)	DEF Donatorët ²⁶	- Numri i programeve buxhetore të analizuar nga këndvështrimi gjinor dhe ku aplikohet BPGJ	KBGJ GG
1.2.5. Takime informuese me gra / të reja / vajza dhe burra/të rinj/djem, në të gjithë diversitetin e tyre, mbi rëndësinë e pjesëmarrjes në dëgjimet publike në përgjithësi, e veçanërisht në dëgjimet buxhetore.	Të gjitha drejtoritë komunale që organizojnë dëgjime publike	DEF NJDNJBGJ OJQ ON	2024 - 2026	3,240 € (nga të cilat 1,515 € komuna dhe 1,725 € donatori)	3,240 € (nga të cilat 1,515 € komuna dhe 1,725 € donatori)	3,240 € (nga të cilat 1,515 € komuna dhe 1,725 € donatori)	Drejtoritë komunale Donatorët ²⁷	- 30 takime të zhvilluara (10 në vit) - 300 persona të informuar informuara (100 në vit), ndarë sipas moshës, etnisë, vendbanimit, aftësive, etj.	KBGJ GG

²⁵ Për të realizuar këto trajnime do ofrojë mbështetje edhe UN Women.

²⁶ UN Women dhe DEMOS mund të ofrojnë mbështetje për këtë aktivitet

²⁷ UN Women dhe DEMOS mund të ofrojnë mbështetje për këtë aktivitet

1.2.6. Përgatitja e formave të unifikuara ²⁸ për mbledhjen e të dhënave të ndara sipas seksit dhe karakteristikave të tjera individuale, si dhe publikimin e informacioneve, për të gjitha aktivitetet që organizon komuna.	DA	NJDNJBGI Zyra e Informimit (ZI) OIQ ON	2024	2,050 € (nga të cilat 1,050 € komuna dhe 1,000 € donatori ²⁹)	/	/	DA	- Format e përgatitura - Të dhënat që mbledhen të ndara, bazuar në plotësimin e tyre.	KBGI GG
1.2.7. Mbledhja e të dhënave bazë për të gjithë treguesit në nivel objektiv specifik, të përcaktuar për matjen e progresit të këtij PLVBGI.	Të gjitha drejtoritë komunale përgjegjëse	NJDNJBGI OIQ ON	2024	400 € (komuna)	/	/	Drejtoritë komunale	- Tabela me të dhëna të plotësuar të vlerës bazë për secilin tregues të objektivave specifike	KBGI GG
1.2.8. Shtimi në faqen zyrtare të internetit të Komunës, i një vegëze me informacione dedikuar çështjeve të Barazisë Gjinore dhe përditësimi rregullisht i saj.	Njësia e Komunikimit me Publikun (NJKP)	NJDNJBGI Të gjitha drejtoritë komunale përgjegjëse	2024 - 2026	2,475 € (komuna)	2,700 € (komuna)	2,700 € (komuna)	NJKP Të gjitha drejtoritë komunale përgjegjëse	- Vegëza e shtuar. -Informacioni i përditësuar rregullisht.	KBGI GG
1.2.9. Publikimi i gjetjeve nga monitorimi i zbatimit të këtij Plani Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore.	NJKP	NJDNJBGI Të gjitha drejtoritë komunale përgjegjëse	2024 - 2026	2,300 € (komuna)	2,300 € (komuna)	2,300 € (komuna)	NJKP Të gjitha drejtoritë komunale përgjegjëse	- Gjetjet e publikuara në mënyrë të përvitshme, bazuar në raportin e plotë	KBGI GG

²⁸ Këtu bëhet fjalë për unifikimin e mbledhjes së të dhënave për pjesëmarrësit / pjesëmarrësit në të gjitha aktivitetet që zhvillon komuna, pavarësisht drejtorisë e fushës përkatëse. Pra do përgatitet një tabelë (p.sh. në Excel) me të gjithë specifikimet që duhet të përmbajnë të dhënat (si p.sh. numri i pjesëmarrësve / pjesëmarrësve, seksi, moshë, etnia, aftësia e kufizuar, vendbanimi...etj.) dhe në bazë të saj do unifikohen edhe listat e pjesëmarrjes që duhet të plotësohen në çdo aktivitet. Ngjashmërisht, do përgatitet një fletë me udhëzime për mënyrën se si do të përgatitet informacioni për publikim në faqen e internetit të komunës, të zbatimit të aktiviteteve përkatëse në këtë PLVBGI.

²⁹ Për zbatimin e këtij aktiviteti do të ofrojnë mbështetje edhe DEMOS dhe UN Women

								të monitorimit të zbatimit të PLVBGJ	
1.2.10. Fuqizimi i NJDNJBGJ (shtim i dy zyrtareve/zyrtarëve me kohë të plotë dedikuar BGJ)	Zyra e Burimeve Njerëzore (ZBNJ)	ZK	2025 - 2026	/	13,320 € (hendet financiar) ³⁰	13,320 € (hendet financiar) ³¹	ZBNJ	- Dy zyrtare/zyrtarë me kohë të plotë dedikuar çështjeve të BGJ të shtuar në strukturë	KBGJ GG
1.2.11. Trajnimi i zyrtareve/zyrtarëve komunalë për përdorimin e gjuhës së ndjeshme gjinore, gjithëpërfshirëse dhe jo-diskriminuese.	NJDNJBGJ	ABGJ OJQ ON	2024 - 2026	1,275 € (nga të cilat 150 € komuna dhe 1,125 € hendet financiar)	1,275 € (nga të cilat 150 € komuna dhe 1,125 € hendet financiar)	1,275 € (nga të cilat 150 € komuna dhe 1,125 € hendet financiar)	ZK Donatorët	- 3 trajnime të realizuara (1 në vit) -60 persona të trajnuar (20 në vit), ndarë sipas seksit, moshës, profesionit, etj.	KBGJ GG
1.2.12. Përdorimi i gjuhës së ndjeshme gjinore në dokumentet dhe politikat e komunës.	Të gjitha drejtoritë përgjegjëse	NJKP NJDNJBGJ	2024 - 2026	9,240 € (komuna)	18,480 € (komuna)	18,480 € (komuna)	Drejtoritë komunale	- Dokumentet dhe publikimet e komunës përgatiten me gjuhë të ndjeshme gjinore	KBGJ GG
1.2.13. Sesione informuese mbi raportimin e ndjeshëm gjinor.	ZI	NJDNJBGJ OJQ Mediat lokale	2024 - 2026	1,025 € (nga të cilat 150 € komuna dhe 875 € hendet financiar)	1,025 € (nga të cilat 150 € komuna dhe 875 € hendet financiar)	1,025 € (nga të cilat 150 € komuna dhe 875 € hendet financiar)	Drejtoritë komunale	- 3 sesione të zhvilluara (1 në vit)	KBGJ GG

³⁰ Komuna duhet ta planifikojë këtë shtim të dy zyrtareve në KAB 2025-2027

³¹ Njëlloj si më sipër

		ON						- 30 persona të informuar (10 në vit)	
OBJEKTIVI STRATEGJIK:	2. PROMOVIMI I SHËNDETIT DHE TË DREJTAVE SEKSUALE DHE RIPRODHUESE.								
Rezultatet e pritshme:	2.a. Edukimi mbi shëndetin seksual e riprodhues mes profesionisteve/profesionistëve dhe në komunitet, merr rëndësi të veçantë. 2.b. Vendimmarrja tek vajzat, djemtë, të rejat, të rinjtë, gratë dhe burrat për shëndetin seksual e riprodhues, e përmirësuar ndjeshëm.								
